



ПРОГРАМА ЗА ПАРЛАМЕНТАРНА ПОДДРШКА  
PROGRAMI PËR MBËSHËTETJE PARLAMENTARE  
PARLIAMENT SUPPORT PROGRAMME

Dokument i shkurtë për politika publike nr.46/2020


-

**Të rinjtë dhe politika në  
Maqedoninë e Veriut:  
Cili është perceptimi mbi  
punën e Kuvendit?**

Autori: Nikola Mihajlovski

-

Nëntor 2020





*Ky publikim është përpiluar në kuadër të Programit për Mbështetje Parlamentare (PSP), i cili mbështetet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) përmes Ambasadës Zvicerane në Republikën e Maqedonisë së Veriut. PSP implementohet nga Instituti Kombëtar Demokratik (NDI), Instituti për Demokraci "Societas Civis" - Shkup (IDSCS) dhe Qendra për Menaxhim me Ndryshime (QMN). Përmbajtja e botimit në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pikëpamjet e SDC-së.*



## Rezyme ekzekutive

---

Zhvillimi i një vendi varet veçanërisht nga vlerat dhe pozitat e gjeneratave të reja në lidhje me çështje të ndryshme në shoqëri. Perceptimi mbi të rinjtë - të pa interesuar për proceset politike - mbizotëron në diskursin që lidhet me perceptimin e përgjithshëm mbi politikën.

Të rinjtë në Evropën Juglindore, përfshirë Maqedoninë e Veriut, kanë njohuri të pamjaftueshme për politikën, interes të dobët për të ndjekur ngjarjet politike dhe nivel të ulët besimi në institucionet kombëtare.<sup>1</sup> Shumica e të rinjve ndihen të përjashtuar nga procesi i vendimmarrjes dhe kanë perceptim se interesat e tyre nuk përfaqësohen sa duhet nga politikanët.<sup>2</sup>

Shumica e të rinjve në Maqedoninë e Veriut besojnë se Kuvendi është përgjithësisht i mbyllur për publikun,

ndërsa shumica e tyre deklarojnë se nuk janë të njoftuar me mekanizmat dhe as nuk janë përpjekur të përfshihen në punën e tij.

Besimi që të rinjtë nga Maqedonia e Veriut e kanë në Kuvend është relativisht i ulët, duke e vlerësuar atë me 4.1 në shkallën nga 1 - më e ulët, deri në 10 - më e larta. Përkundër faktit se shumica e të rinjve Kuvendin e shohin si institucion të rëndësishëm që ka rol të rëndësishëm në jetën politike të vendit, ata ende besojnë se Qeveria në një farë mase kontrollon punën e Kuvendit.

Duhet përpjekje shtesë nga Kuvendi për përmirësimin e perceptimit të të rinjve për punën e tij. Kjo mund të arrihet duke forcuar rolin mbikëqyrës të Kuvendit mbi Qeverinë, përmes përdorimit më aktiv dhe më të rregullt të mekanizmave mbikëqyrës; hapjen më të madhe të Kuvendit për informimin dhe përfshirjen e të rinjve në punën e Kuvendit; dhe fokusim thelbësor i Kuvendit mbi nevojat dhe sfidat me të cilat përballen të rinjtë.

---

<sup>1</sup> JusiQ, M. (2019) Tjetërsimi politik i gjeneratës së pasigurt. Fondacioni Friedrich Ebert. Në dispozicion në: <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/sarajevo/15553.pdf?fbclid=IwAR2xSQeJlWcu7LmdekAHMcfKTDWU2E-oCt-hc-TDNWJcShqnnJYVWPoYh2M>

<sup>2</sup> JusiQ, M. Lavriq, M. dhe Tomanoviq, S. (2019) Studimi i Rinisë së Evropës Juglindore 2018/2019: Pjesëmarrja Politike dhe Qytetare. Fondacioni Friedrich Ebert. Në dispozicion në: <http://library.fes.de/pdf-files/id-moe/15274-20190408.pdf>

# 1. Hyrje

---

Drejtimi i zhvillimit të ardhshëm të një vendi dukshëm varet nga vlerat dhe njohuritë e gjeneratave të reja. Prandaj, është veçanërisht e rëndësishme të identifikohet pozicioni i të rinjve në shoqëri dhe të shihen pikëpamjet dhe perceptimet e tyre për çështje të ndryshme. Në diskursin në lidhje me perceptimin për politikën të kuptuar në nocionin e saj më të gjerë, mbizotëron narracioni se të rinjtë kanë pak besim në institucionet politike dhe interes të dobët për proceset politike.

Analizat tregojnë se perceptimi i të rinjve nga Maqedonia e Veriut është në linjë me mendimet e të rinjve në Evropën Juglindore.<sup>3</sup> Kështu, edhe këtu të rinjtë ndihen të përjashtuar nga proceset

e vendimmarrjes në shoqëri, nuk kanë njohuri të mjaftueshme për mekanizmat me të cilët mund të përfshihen në ato procese dhe kanë besim të ulët në dhomën ligjvënëse.

Qëllimi i kësaj analize është të paraqesë perceptimet e të rinjve rreth aktorëve politikë, veçanërisht për punën e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të japë pasqyrë krahasuese me moshatarët e tyre nga rajoni. Ky perceptim është shqyrtuar përmes prizmit të besimit të cilin ky grup i qytetarëve e ka në institucionet publike, si dhe informimit dhe dëshirës së të rinjve të marrin pjesë në punën e tyre.

---

<sup>3</sup> Njësoj<sup>2</sup>

## 2. Të rinjtë dhe politika në Evropën Juglindore: Cili është perceptimi mbi punën e dhoma ligjvënëse?


Qëndrimi ndaj politikës, i të rinjve nga vendet e Evropës Juglindore (EJL) është në të njëjtin nivel me qëndrimin ndaj politikës që kanë moshatarët e tyre nga pjesë të tjera të Evropës. Ky përfundim konfirmohet nga hulumtimet të cilat konkludojnë se të rinjtë nga vendet e EJL-ve, në përgjithësi kanë mosbesim ndaj institucioneve politike në vendet e tyre dhe kanë pak interes dhe njohuri të përgjithshme për fusha të ndryshme të politikës.<sup>4</sup>

Megjithatë, analizat krahasuese tregojnë se dallimet në kulturën politike midis vendeve reflektohen në segmente të caktuara të të menduarit dhe të veprimit të të rinjve. Kështu, shkalla e besimit politik dhe pjesëmarrjes së të rinjve ndryshon nga vendi në vend.

### 2.1. Përfshirja në procesin e vendimmarrjes

Shumica e të rinjve nga të gjitha vendet e EJL-së, nuk shohin aleat në bartësit e funksioneve politike në vendet e tyre. Ky perceptim negativ i politikanëve është më i theksuar tek të rinjtë në Bosnjë dhe Hercegovinë, ku rreth 86% e të rinjve mendojnë se politikanët nuk kujdesen për mendimin e tyre. Në Maqedoninë e Veriut, (61%) e të rinjve mendojnë se politikanët nuk kujdesen për mendimet dhe qëndrimet e tyre. Megjithëse kjo përqindje është më e ulët se pothuajse të gjitha vendet e tjera në Evropën Juglindore (përveç Sllovenisë - 54%) përsëri tregon se shumica e të rinjve në shtet nuk besojnë se pikëpamjet dhe qëndrimet e tyre përfaqësohen mjaftueshëm nga politikanët (Grafiku 1).

Grafiku 1. Grup-mosha: Të rinjtë 14-29 vjeç, 2018/19



Burimi: Studimi i të rinjve nga Evropa Juglindore 2018/2019, FES


<sup>4</sup> Njësoj<sup>1</sup>

Në linjë me këtë përshtypje të të rinjve, është edhe mendimi se interesat e tyre përgjithësisht nuk përfaqësohen sa duhet në jetën politike të vendit. Kërkimet e Jusiq dhe të tjerë (2019) tregojnë se ky perceptim i përjashtimit nga politikat kombëtare është më i dukshëm në rastin e Rumanisë, ku më shumë se dy të tretat e të rinjve mendojnë se ndihen më pak të përfaqësuar në politikat kombëtare (68%), ndërsa më pak është e theksuar në Maqedoninë

e Veriut, ku (46%) e të rinjve e ndajnë atë mendim. Si pasojë, shumica e të rinjve nga të gjitha vendet e rajonit gjithashtu kanë deklaruar se duhet të fitojnë më shumë mundësi që të prononcohen në lidhje me pikëpamjet e tyre mbi politikat e vendit. Përshtypja e këtillë i bën të rinjtë e EJK-së, të pa interesuar për politikat kombëtare që po ndodhin në vendet e tyre (Grafiku 2).

**Grafiku 2.** Grup-mosha: Të rinjtë 14-29 vjeç, 2018/19.

### Perceptimet e të rinjve (14-29) mbi situatën socio-politike në kontekstin kombëtar, 2018/19



- Interesat e të rinjve nuk janë përfaqësuar mjaftueshëm në politikën kombëtare
- Të rinjtë duhet të kenë më tepër mundësi të flasin për politikën
- Asnak nuk më intereson politika kombëtare” Grup mosha: (16-27)

Burimi: Studimi i të rinjve nga Evropa Juglindore 2018/2019, FES

<sup>5</sup> Njësoj <sup>2</sup>




## 2.2. Besimi në institucionet: Si është gjendja me besimin në dhomat ligjvënëse kombëtare?

Besimi politik është tregues i rëndësishëm për legjitimitetin politik, besimin në drejtësinë e institucioneve politike dhe sistemin, pjesë e të cilit janë vetë qytetarët. Besimi në institucionet politike është temë interesi i shumë studimeve, veçanërisht për shkak të konstatimeve që tregojnë nivel në rënie të besimit politik në demokracitë perëndimore, në dekadat e fundit.<sup>6</sup>

Të rinjtë e EJK-së, kanë besim të ulët në dhomat ligjvënëse. Kështu, në Malin e Zi, në shkallën nga 1 më e ulëta në 5 më e larta, rezultati mesatar me të cilin të rinjtë vlerësuan besimin e tyre për Kuvendin është 2.3, në Slloveni 2.2, Kosovë 1.9 (Grafiku 3). Në krahasim, të rinjtë nga vendet Nordike: Danimarka, Finlanda dhe Suedia, kanë besimin më të lartë në dhomat ligjvënëse të vendeve të tyre, me notë mesatare mbi gjysmën e shkallës.<sup>7</sup>

**Grafiku 3.** Grup-mosha: Të rinjtë 14-29 vjeç, 2018/19.

### Të rinjtë nga Ballkani me besim të ulët në dhomat e tyre ligjvënëse



Burimi: Studimi i të rinjve nga Evropa Juglindore 2018/2019, FES

<sup>6</sup> Turper, S. dhe Arts, K. (2015) Besimi politik dhe sofistikimi: ndërmarra e masave serioze. Në dispozicion në: <https://doi.org/10.1007/s11205-015-1182-4>

<sup>7</sup> Amio, Ana-Rika. (2017) SI ËSHTË NDËRTUAR BESIMI? Në dispozicion në : <https://trepo.tuni.fi/bitstream/handle/10024/102172/GRADU-1507723190.pdf?sequence=1&isAllowed=y>

## 3. Të rinjtë dhe politika në Maqedoninë e Veriut: Cili është perceptimi mbi punën e Kuvendit


### 3.1. Përfshirja në punën e Kuvendit

Kërkimet në Maqedoninë e Veriut tregojnë interesim të vogël dhe njohuri të të rinjve për jetën politike të vendit, si dhe përjashtimin e tyre nga procesi i vendimmarrjes. Kjo situatë i bën shumicën e të rinjve pesimistë edhe në lidhje me atë se sa ofron perspektivë shoqëria për të rinjtë.

Lidhur me perceptimin e tyre për Kuvendin e Maqedonisë së Veriut, më shumë se gjysma e të rinjve mendojnë se ky institucion është pjesërisht ose plotësisht i mbyllur për pjesëmarrjen e publikut në punën e tij (Grafiku 4).<sup>9</sup>

**Grafiku 4.** Të rinjtë mendojnë se për ta, Kuvendi është i mbyllur plotësisht ose pjesërisht

**Të rinjtë mendojnë se për ta, Kuvendi është i mbyllur plotësisht ose pjesërisht**



Burimi: Sondazh mbi perceptimet e qytetarëve për punën e Kuvendit, 18-29 vjeç, 2020, IDSCS

<sup>8</sup> Galevski, M. (2019) Pjesëmarrja socio-politike e të rinjve në Maqedoninë e Veriut: Apatia, optimizmi ose zhgënjimi; Pjesëmarrja në proceset institucionale të vendimmarrjes. Fondacioni për Demokraci në Westminster, Maqedonia e Veriut. Në dispozicion në: <https://www.wfd.org/wp-content/uploads/2019/12/WFD-Youth-NMK.pdf>


<sup>9</sup> Rezultatet nga studimi në terren (2020) mbi perceptimet e qytetarëve për punën e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. IDSCS. Në dispozicion në: <https://bit.ly/2GqmAkv>

Anketë në terren, e kryer nga IDSCS në kuadër të Mbështetjes Parlamentare (PSP) gjithashtu konfirmon nivelin e ulët të njohjes së mekanizmave për përfshirjen në punën e Kuvendit. Kështu, madje (86%) e të rinjve nuk janë të informuar aspak se si ata mund të ushtrojnë të drejtën e tyre për të marrë

pjesë në punën e Kuvendit. Krahasuar me përgjigjet e grup-moshës mbi 30 vjeç (83%), mund të vërehet se kjo mungesë informacioni tek të rinjtë e moshës 18-29 vjeç është më e lartë për tre pikë të përqindjes (Grafiku 5).<sup>10</sup>

**Grafiku 5.** Të rinjtë nuk janë të informuar se si mund të marrin pjesë në punën e Kuvendit,

### Të rinjtë nuk janë të informuar se si mund të marrin pjesë në punën e Kuvendit




Burimi: Sondazh mbi perceptimet e qytetarëve për punën e Kuvendit, 18-29 vjeç, 2020, IDSCS

<sup>10</sup> Njësoj<sup>9</sup>

Në përputhje me nivelin e ulët të informimit të të rinjve për mekanizmat e përfshirjes në punën e

Kuvendit, shumica e të rinjve (93%) kurrë nuk janë përpjekur të marrin pjesë në punën e tij (Grafiku 6).

**Grafiku 6.** Një numër i madh i të rinjve nuk janë përpjekur të marrin pjesë në punën e Kuvendit.




Burimi: Sondazh mbi perceptimet e qytetarëve për punën e Kuvendit, 18-29 vjeç, 2020,

### 3.2. Besimi në pushtetin legjislativ, gjyqësor dhe ekzekutiv të shtetit

Të rinjtë në Maqedoninë e Veriut kanë besim të ulët në institucionet shtetërore dhe perceptimi i tyre përkon me perceptimin e të anketuarve mbi 30 vjeç. Kështu, në shkallën nga 1 - më e ulëta në 10 - më e larta, të rinjtë vlerësuan besimin ndaj Kuvendit, Qeverisë, Gjyqësorit dhe Presidentit të vendit me nota nën mesataren.<sup>11</sup> Të rinjtë kanë më pak besim në punën e gjykatave, të cilën e vlerësuan me 3.3

ndërsa besim më të madh kanë në punën e Presidentit të shtetit, 4.3. Lidhur me Kuvendin, të rinjtë vlerësuan besimin e tyre ndaj këtij institucioni me notën mesatare 4.1. Ndryshimi më i madh për sa i përket perceptimit të të anketuarve mbi 30 vjeç, vërehet në besimin te Presidenti, të cilin qytetarët e moshës mbi 30 vjeç e vlerësuan me notën 4.8, që është për 0.5 më e lartë se nota të cilën e dhanë rinjtë të moshës deri në 29 vjeç (Grafiku 7).

Grafiku 7. Të rinjtë me besim të ulët në Kuvendin.



Burimi: Sondazh mbi perceptimet e qytetarëve për punën e Kuvendit, 18-29 vjeç, 2020, IDSCS

<sup>11</sup> Njësoj<sup>9</sup>


### 3.3. Roli i Kuvendit në jetën politike të vendit

Shumica e të rinjve, Kuvendin e shohin si institucion të rëndësishëm, i cili ka rol të rëndësishëm në jetën

politike në vend (58%), ndërsa më pak se një e treta e të rinjve kanë pikëpamje të kundërt (28%, Grafiku 8).<sup>12</sup>

**Grafiku 8.** Të rinjtë besojnë se Kuvendi luan rol të rëndësishëm në jetën politike të vendit.

#### Të rinjtë besojnë se Kuvendi luan rol të rëndësishëm në jetën politike të vendit




Burimi: Sondazh mbi perceptimet e qytetarëve për punën e Kuvendit, 18-29 vjeç, 2020,

Nga ana tjetër, edhe përkundër këtij perceptimi pozitiv të rolit të Kuvendit, dy të tretat e të rinjve (65%) konsiderojnë se Qeveria deri në një shkallë ka kontrollon mbi Kuvendin, përkundër faktit se kompetenca kushtetuese e Kuvendit e parashikon

të kundërtën, dhoma ligjvënëse të zgjedhë dhe të kryejë mbikëqyrje mbi Qeverinë. Rreth një e treta e të rinjve pajtohen plotësisht ose pjesërisht me konstatimin se Kuvendi është ai që kontrollon Qeverinë (36%, Grafiku 9).

<sup>12</sup> Njësoj<sup>9</sup>

**Grafiku 9.** A e kontrollon Qeveria Kuvendin apo Kuvendi e kontrollon Qeverinë?



Burimi: Sondazh mbi perceptimet e qytetarëve për punën e Kuvendit, 18-29 vjeç, 2020, IDSCS

## 4. Përfundim

---

Qëndrimet dhe perceptimet për punën e institucioneve politike, përfshirë kuvendet kombëtare, të të rinjve në Maqedoninë e Veriut nuk ndryshojnë thelbësisht nga perceptimet e moshatarëve të tyre nga Evropa Juglindore. Shumica e të rinjve në EJK-të, ndajnë mendimin se ata janë të përjashtuar politikisht nga vendimmarrja dhe kanë perceptim se interesat e tyre nuk përfaqësohen sa duhet nga politikanët. Interesi për politikën kombëtare ndryshon midis të rinjve, por zakonisht është me intensitet të ulët.

Qëndrimet e të rinjve në Maqedoninë e Veriut, tregojnë se ata e perceptojnë Kuvendin si faktor të rëndësishëm në skenën politike të vendit

dhe besojnë në rolin e rëndësishëm që ka ky institucion, por megjithatë dyshojnë në pavarësinë e tij politike gjatë vendimmarrjes. Për më tepër të rinjtë në vend, në përputhje me bashkëqytetarët e tyre të grup - moshave më të vjetra, kanë besim të ulët në Kuvendin dhe janë plotësisht të përjashtuar nga puna e tij, kryesisht për shkak të mungesës së informacionit në lidhje me mekanizmat për përfshirjen e tyre. Ky perceptim tek të rinjtë, gjeneron pengesë për përfshirjen e tyre pro-aktive në punën e Kuvendit, i largon ata nga përfaqësuesit e tyre të zgjedhur dhe i dekurajon nga ndërmarrja e veprimeve për përfaqësimin e pikëpamjeve dhe pozicioneve të tyre në dhomën ligjvënëse



## 5. Rekomandime

—

Për këto shkaqe, duhen përpjekje shtesë nga Kuvendi për përmirësimin e perceptimit dhe pozicionin e të rinjve. Një nga mënyrat është me **forcimin e rolit mbikëqyrës të Kuvendit mbi Qeverinë, përmes përdorimit më aktiv dhe më të rregullt të mekanizmave mbikëqyrës**. Në këtë mënyrë, do të kontribuohet në rritjen e besimit të të rinjve për pavarësinë politike të Kuvendit.

**Duhet edhe hapje më e madhe e Kuvendit për informimin dhe përfshirjen e të rinjve në punën e Kuvendit.** Niveli i lartë i mungesës së informacionit

tek të rinjtë është pengesë serioze që mund të kapërcehet duke zbatuar programe të ndryshme për përfshirjen e të rinjve në punën e Kuvendit.

**Kuvendi, gjithashtu, në mënyrë esenciale duhet t'i vendos të rinjtë në fokusin e punës së tij.** Në këtë mënyrë, duke marrë parasysh nevojat e të rinjve, dhe duke rishikuar zgjidhjet nga këndvështrimi se si ato do të ndikojnë tek të rinjtë në vend, do të rezultojë me përmirësimin e pozitës së të rinjve dhe përmirësimin e perceptimit dhe besimit të tyre në punën e Kuvendit.



ПРОГРАМА ЗА ПАРЛАМЕНТАРНА ПОДДРШКА  
PROGRAMI PËR MBËSHËTETJE PARLAMENTARE  
PARLIAMENT SUPPORT PROGRAMME

Dokument i shkurtë për politika publike nr.46/2020

-

**Të rinjtë dhe politika në  
Maqedoninë e Veriut:  
Cili është perceptimi mbi  
punën e Kuvendit?**

Autori: Nikola Mihajlovski

-

Nëntor 2020